



SIGURIA NË INTERNET

PRINDËR MBRONI FËMIJËT TUAJ !

Çfarë rreziqesh mund të vijnë nga interneti:

- Ç'edukimi i fëmijëve si pasojë e marrjes së informacionit të pakontrolluar;
- Krijimi i lidhjeve me të rritur që përbëjnë rrezik për fëmijën tuaj;
- Ngacmimi përmes internetit;
- Nisja virtuale e konflikteve dhe përfundimi real i tyre.

Çfarë duhet të bëni ju si prindër?

- Shpjegojuni fëmijëve mbi rrezikun që paraqet përdorimi i internetit;
- Bëjini të ditur fëmijëve se sa e rëndësishme është që ata t'ju tregojnë për çfarëdo dyshimi që mund të kenë, ose nëse ngacmohen përmes internetit;
- Jini gjithmonë të informuar mbi aktivitetet që bëjnë fëmijët online;
- Tregoni fëmijëve se nuk duhet pranuar asnjë aktivitet online që ka për qëllim të frikësojë, kërcënojë, ngacmojë ose të dëmtojë ata ose dikë tjetër;
- Këshillojini fëmijët të injorojnë çdo lloj mesazhi të dyshimtë.

Nëse konstatooni ngacmime, çfarë duhet bërë?

- Udhëzoni fëmijën të mos i fshijë mesazhet nga ngacmuesit. Mesazhet mund të shërbejnë si provë.
- Përdorni software për të bllokuar ngacmuesit dhe aktivizoni komandën “privacy settings” në faqet e rrjeteve sociale.
- Nëse ngacmimet janë të rënda dhe vazhdojnë për një kohë të gjatë, **NJOFTONI** policinë.

Çfarë parashikon ligji Shqiptar lidhur me krimin kompjuterik?

1. Cënimi i privatësisë së tjetrit është vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
2. Ofendimi, fyerja dhe kërcënimi online janë dhunë dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

**MOS JI INDIFERENT!
TELEFONO 129**

Ky numër është në shërbimin Tuaj pa pagesë



Financuar nga
Programi Suedez për
Policimin në Komunitet


SACP Programme